

**PROTOKOLL I  
MARRËVESHJES SË MADRIDIT PËR  
REGJISTRIMIN NDËRKOMBËTAR  
TË MARKAVE TREGTARE  
(SHENJAVE)**

Shpallur në "Gazetën zyrtare të RM-së" nr. 12/02 të 16 shkurtit të vitit 2002.

## Neni 1

### *Anëtarësimi në Unionin e Madridit*

Shtetet anëtare të këtij Protokollit (në tekstin e mëposhtëm “Palët nënshkruese”), që nuk janë anëtarë të Marrëveshjes së Madridit për regjistrim ndërkombëtar të markave tregtare, rishikuar në Stokholm në vitin 1967 dhe plotësuar në vitin 1979 (në tekstin e mëposhtëm “Marrëveshja e Madridit”), dhe organizatat e cekura në nenin 14 (1) (b) që janë anëtare të Protokollit (në tekstin e mëposhtëm “organizatat nënshkruese”) bëhen anëtare të të njëjtit Union anëtarët e të cilit janë shtetet e marrëveshjes së Madridit. Termi “palët nënshkruese” në këtë protokoll ka të bëjë me shtetet nënshkruese dhe organizatat nënshkruese.

## Neni 2

### *Sigurimi i mbrojtjes përmes regjistrimit ndërkombëtar*

(1) Në qoftë se aplikimi për regjistrim të markës tregtare është dorëzuar në Entin e palës nënshkruese, ose në qoftë se shenja (marka tregtare) është regjistruar nga ana e Entit të palës nënshkruese, personi, në emër të të cilit aplikacioni (në tekstin e mëposhtëm “aplikacioni bazë”) ose regjistrimi (në tekstin e mëposhtëm “regjistrimi bazë”) është kryer, sipas dispozitave të këtij Protokollit, mund të përfitojë (marrë) mbrojtje të shenjës (markës tregtare), përmes shpalljes së regjistrimit të asaj shenje në regjistrin e Byrosë ndërkombëtare të Organizatës botërore për pronësi industriale (në tekstin e mëposhtëm “Regjistrimi ndërkombëtar”, “Regjistri ndërkombëtar”, “Byroja ndërkombëtare” dhe “Organizata”), duke siguruar që:

- (i) në qoftë se aplikacioni bazë është parashtruar (dorëzuar) deri te Enti i palës nënshkruese ose në qoftë se regjistrimi bazë është bërë nga ana e atij Enti, personi, në emër të të cilit është bërë aplikimi ose regjistrimi është shtetas i palës nënshkruese, ose jeton aty, ose ka ndërmarrje me seli në palën nënshkruese në fjalë,
- (ii) në qoftë se aplikacioni bazë është dorëzuar deri te Enti i Organizatës nënshkruese ose në qoftë se regjistrimi bazë është bërë nga Enti përkatës, personi në emër të të cilit është bërë aplikimi ose regjistrimi është shtetas i shtetit anëtarë të asaj Organizate, ose nëse jeton aty, ose ka ndërmarrje me seli në territorin e organizatës nënshkruese në fjalë.

(2) Aplikacioni për regjistrim ndërkombëtar (në tekstin e mëposhtëm “Aplikacioni ndërkombëtar”) do të dorëzohet në Byronë ndërkombëtare me ndërmjetësim të Entit ku është dorëzuar aplikacioni bazë ose ku është kryer regjistrimi bazë (në tekstin e mëposhtëm “Enti i origjinës”), në varësi të rastit.

(3) Termi “Ent” ose “Enti i palës nënshkruese” në këtë protokoll ka të bëjë me Entin që ka kryer punën, sipas udhëzimeve të palës nënshkruese, për regjistrimin e

markës tregtare (shenjës), dhe termi “shenjë” në këtë Protokoll ka të bëjë me markat tregtare dhe ato shërbyese.

(4) “Territori i palës nënshkruese” në këtë protokoll do të thotë, në qoftë se pala nënshkruese është shtet, territorin e atij shteti dhe, në qoftë se pala nënshkruese është organizatë ndërqeveritare, territorin ku zbatohet marrëveshja themeltare e organizatës ndërqeveritare.

### **Neni 3**

#### ***Aplikacioni ndërkombëtar***

(1) Çdo aplikacion ndërkombëtar sipas këtij Protokollit duhet të dorëzohet në formë të përcaktuar me Rregullore. Enti i origjinës do të kryej vërtetim mbi atë se të dhënat e cekura në aplikacionin ndërkombëtar janë adekuate me të dhënat që ekzistojnë, në kohën e vërtetimit, në aplikacionin bazë ose në regjistrimin bazë. Më tej, Enti do të evidentojë (shënojë):

- (i) në rast të aplikacionit bazë, datën dhe numrin e aplikacionit;
- (ii) në rast të regjistrimit bazë, datën dhe numrin e atij regjistrimi, gjithashtu edhe datën dhe numrin e aplikacionit sipas të cilit është kryer regjistrimi.

Enti i origjinës do ta shënojë edhe datën e aplikacionit ndërkombëtar.

(2) Në aplikacion duhet të jenë të shënuara mallrat dhe shërbimet për të cilat kërkohet mbrojtja e shenjës (markës), në qoftë se është e mundur, klasa ose klasat adekuate sipas Marrëveshjes së Nicës për klasifikim ndërkombëtar të produkteve dhe shërbimeve për regjistrim të markave. Në qoftë se aplikuesi nuk i dorëzon këto të dhëna, Byroja ndërkombëtare do t'i klasifikojë mallrat dhe shërbimet sipas klasifikimi të lartpërmendur. Përcaktimi i klasave nga ana e aplikuesit do të jetë lëndë e kontrollit të Byrosë ndërkombëtare, e cila do të kryej kontroll në bashkëpunim me Entin e origjinës. Në rast të mospajtimeve midis Entit në fjalë dhe Byrosë ndërkombëtare, do të merret parasysh mendimi i këtij të fundit.

(3) Në qoftë se aplikuesi kërkon që ngjyra të caktohet si element dallues i shenjës (markës) së tij, ai do të duhet:

- (i) ta shënojë (cekë) këtë të dhënë dhe të plotësojë në aplikacionin ndërkombëtarë shënim duke specifikuar ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave që i kërkon;
- (ii) të dorëzojë me aplikacioni ndërkombëtar kopje të shenjës në fjalë me ngjyra, që do të jenë shtesë të shënimit dorëzuar deri te Byroja ndërkombëtare; Numri i këtyre kopjeve do të përcaktohet me Rregullore.

(4) Byroja ndërkombëtare menjëherë do të kryej regjistrimin e shenjave të cekura në nenin 2. Regjistrimi ndërkombëtar do ta mbajë datën kur aplikacioni ndërkombëtar është pranuar në Entin e origjinës, në qoftë se aplikacioni ndërkombëtar është pranuar në

Byronë ndërkombëtare në periudhë prej dy muajve nga ajo datë. Nëse aplikacioni ndërkombëtar nuk është pranuar në atë periudhë, regjistrimi ndërkombëtar do ta bart datën kur aplikacioni ndërkombëtar është pranuar në Byronë ndërkombëtare. Byroja ndërkombëtare do të njoftojë Entin për regjistrimin e kryer ndërkombëtar. Shenjat e regjistruara në Regjistrin ndërkombëtar do të shpallen në revistat periodike që do t'i botojë (shpall) Byroja ndërkombëtare, me të dhënat e cekura në aplikacionin ndërkombëtar.

(5) Çdo Ent, nga Byroja ndërkombëtare do të marr falas disa kopje të revistës në fjalë dhe disa kopje me çmim më të ulët, sipas kushteve të parapara nga Kuvendi ndërsa të përcaktuara në nenin 10 (në tekstin e mëposhtëm “Kuvendi). Këto publikime shërbejnë për nevojat e palëve nënshkruese, dhe asgjë tjetër nuk mund të kërkohet nga bartësit e regjistrimit ndërkombëtar.

### **Neni 3 bis**

#### ***Vlefshmëria territoriale***

Mbrojtja që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar do të zbatohet në të gjitha palët nënshkruese vetëm në bazë të kërkesës së personit që ka plotësuar aplikacionin ndërkombëtar ose që është bartës i regjistrimit ndërkombëtar. Në çdo rast, kërkesa e tillë nuk mund të vijë nga pala nënshkruese enti i së cilës është ent i origjinës.

### **Neni 3 ter**

#### ***Kërkesa për “zgjerim territorial”***

(1) Çdo kërkesë për zgjerim të mbrojtjes, që është rezultat i regjistrimit ndërkombëtar, në cilëndo palë nënshkruese, duhet të jetë e theksuar në veçanti në aplikacionin ndërkombëtar.

(2) Kërkesa për zgjerim territorial gjithashtu mund të bëhet menjëherë pas regjistrimit ndërkombëtar. Kërkesa e tillë duhet të dorëzohet në formën e përcaktuar me Rregullore. Ajo do të vërehet menjëherë në Byronë ndërkombëtare, e cila pa vonesa do ta bart njoftimin deri te Enti ose entet për të cilat bëhet fjalë. Kjo kërkesë do të shpallet në gazetën periodike të Byrosë ndërkombëtare. Kërkesa e tillë për zgjerim territorial do të hyjë në fuqi nga data kur është vërejtur në Regjistrin ndërkombëtar; ajo do të ngelet e vlefshme deri në ditën e skadimit të regjistrimit ndërkombëtar për të cilin bëhet fjalë.

### **Neni 4**

#### ***Rëndësia e regjistrimit ndërkombëtar***

(1) (a) Nga data e regjistrimit ose nga data e vërejtjes (shënimit) sipas dispozitave të neneve 3 dhe 3 ter, mbrojtja e shenjës në secilën nga palët nënshkruese do të jetë e njëjta sikur shenja të jetë deponuar drejtpërdrejt në entet e palëve nënshkruese. Në qoftë se në Byronë ndërkombëtare nuk arrin asnjë refuzim sipas nenit 5 (1) dhe (2) ose në qoftë se refuzimet vërehen më vonë sipas nenit të lartpërmendur, mbrojtja e shenjës në palën nënshkruese do të jetë e njëjtë, nga data e specifikuar, sikur shenja të jetë regjistruar nga enti i palës nënshkruese.

(b) Caktimi i klasave të produkteve dhe shërbimeve të parapara me nenin 3 nuk do ta përcaktojë mbrojtjen e shenjës në palët nënshkruese.

(2) Çdo regjistrim ndërkombëtar do të gëzojë të drejtën e prioritetit të paraparë me nenin 4 të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, pa marrë parasysh formalitetet e parapara në nënpjesën D të atij neni.

#### **Neni 4 bis**

##### ***Zëvendësimi i regjistrimit nacional ose regional me regjistrim ndërkombëtar***

(1) Në qoftë se shenja që është lëndë e regjistrimit nacional ose regional në entin e palës nënshkruese bëhet lëndë e regjistrimit ndërkombëtar dhe në qoftë se dy regjistrimet janë në emër të të njëjtit person, regjistrimi ndërkombëtar do ta zëvendësojë regjistrimin nacional ose regional, pa pasoja mbi të drejtat e fituara, duke siguruar:

- (i) mbrojtje e cila si rezultat i regjistrimit ndërkombëtar shtrihet dhe në palën nënshkruese në fjalë sipas nenit 3 ter (1) ose (2).
- (ii) të gjitha produktet dhe shërbimet e cekura në regjistrimin nacional ose regional barten edhe mbi regjistrimin ndërkombëtar në palën nënshkruese.
- (iii) ky zgjerim hyn në fuqi sipas datës së regjistrimit nacional ose regional.

(2) Enti i cekur në paragrafin (1), në kërkesë, këtë do ta shënojë në regjistrin e vet të regjistrimit ndërkombëtar.

#### **Neni 5**

##### ***Refuzimi dhe anulimi (shfuqizimi) i regjistrimit ndërkombëtar te palët nënshkruese***

(1) Aty ku legjislacioni i zbatueshëm e lejon këtë, çdo Ent i palës nënshkruese që është njoftuar nga Byroja ndërkombëtare për zgjerimin e asaj pale nënshkruese, sipas nenit 3 ter (1) ose (2), të mbrojtjes, e cila është rezultat i regjistrimit ndërkombëtar, ka të drejtë të deklarohet me deklaratë për refuzim, se ajo mbrojtje nuk mund të garantohet në atë palë nënshkruese për shenjën e cila është lëndë e atij zgjerimi. Ky refuzim mund të bazohet vetëm mbi bazën e dispozitave të aplikueshme, sipas Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, në rastin kur shenja të jetë e deponuar drejtpërdrejt te

Enti i cili njofton për refuzimin. Sidoqoftë, mbrojtja mund të mos refuzohet, madje edhe pjesërisht, përveç nëse legjislacioni i aplikueshëm lejon regjistrim vetëm të një pjese të caktuar të klasave ose të një numri të caktuar të produkteve dhe shërbimeve.

(2) (a) Çdo Ent që dëshiron të përdorë këtë të drejtë do të njoftojë Byronë ndërkombëtare për refuzimin, bashkë me deklaratën për të gjitha bazat, në periudhë kohore të përkohshme në ligjin e aplikueshëm në atë Ent dhe sipas pikave (b) dhe (c), para skadimit të afatit prej një viti nga data në të cilën njoftimi për atë zgjerim i cekur në paragrafin (1) është dërguar deri tek ai Ent nga Byroja ndërkombëtare.

(b) Duke mos mohuar pikën (a), çdo palë nënshkruese mund të deklarohet se, për regjistrim ndërkombëtar të fituar (kryer) sipas Protokollit, koha e kufizuar prej një viti në pikën (a) zëvendësohet me 18 muaj.

(c) Kjo deklaratë, gjithashtu mund të specifikojë se, kur refuzimi i mbrojtjes është rezultat i ankimit për njohjen e mbrojtjes, ai refuzim mund të dorëzohet nga Enti i palës nënshkruese deri te Byroja ndërkombëtare pas skadimit të afatit prej 18 muajve. Ai Ent, në lidhje me të gjitha regjistrimet e dhëna ndërkombëtare, mund të deklarojë refuzim të mbrojtjes pas skadimit të afatit prej 18 muajve, vetëm nëse:

- (i) para skadimit të afatit prej 18 muajve, ka informuar Byronë ndërkombëtare për mundësitë për atë opsion pas skadimit të afatit kufizues prej 18 muajve, dhe
- (ii) njoftimi për refuzim bazuar në kundërshtimin është bërë në afatin e kufizuar, por, jo më shumë se shtatë muaj nga data e fillimit të periudhës së kundërshtimit (ankimit); në qoftë se periudha e kundërshtimit skadon para këtij afati prej shtatë muajsh, njoftimi duhet të bëhet në periudhën e kufizuar prej një muaji nga skadimi i periudhës së kundërshtimit.

(d) Çdo deklaratë sipas pikave (b) ose (c) mund të bëhet me instrumentet e cekura në nenin 14 (2) dhe data e hyrjes në fuqi të deklaratës do të jetë e njëjta datë kur ky Protokoll hyn në fuqi në lidhje me organizatat ndërqeveritare që kanë dorëzuar deklaratën. Çdo deklaratë e tillë mund të bëhet më vonë, në atë rast deklarata do të hyjë në fuqi tre muaj pas pranimit nga ana e Drejtorit gjeneral të Organizatës (në tekstin e mëposhtëm “Drejtori gjeneral”), ose më vonë nëse është caktuar (shënuar) në deklaratë, në lidhje me çdo regjistrim ndërkombëtar data e të cilit është e njëjtë ose më e vonshme se data e hyrjes në fuqi të deklaratës.

(e) Pas skadimit të periudhës prej dhjetë viteve nga hyrja në fuqi e këtij Protokollit, Kuvendi do të shqyrtojë funksionimin e sistemit të vendosur nga pikat nga (a) deri në (d). Më pas, dispozitat e pikave në fjalë mund të ndryshohen me vendim të Kuvendit.

(3) Byroja ndërkombëtare, pa vonesa, do të dërgojë një nga kopjet e deklaratës për refuzim deri te bartësi i regjistrimit ndërkombëtar. Bartësi në fjalë do t'i ketë të njëjtat mjete juridike në dispozicion sikur Enti që ka deklaruar refuzimin t'i jetë drejtuar drejtpërdrejt atij. Kur Byroja ndërkombëtare të ketë pranuar informacionit sipas paragrafit (2)(c)(i), pa vonesa, ajo do ta bartë atë informacion deri te bartësi i regjistrimit ndërkombëtarë.

(4) Bazat për refuzimin e shenjës do të dorëzohen nga Byroja ndërkombëtare deri te secila palë e interesuar që kërkon një gjë të tillë.

(5) Çdo Ent që nuk ka dorëzuar, në lidhje me regjistrimin e dhënë ndërkombëtarë, çfarëdo qoftë refuzimi kornizë apo përfundimtarë deri te Byroja ndërkombëtare në lidhje me paragrafët (1) dhe (2) lidhur me regjistrimin ndërkombëtar, do t'i humbasë përfitimet e asaj të drejte të parashikuara në paragrafin (1).

(6) Anulimi nga autoritetet kompetente të palës nënshkruese, i vlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar në territorin e palës nënshkruese, nuk mund të shpallet, pa mos pasur mundësi bartësi të mbrojë të drejtat e veta të regjistrimit ndërkombëtar. Anulimi do të regjistrohët tek Byroja ndërkombëtare.

### **Neni 5 bis**

#### ***Evidenca për përdorim ligjor të elementëve të caktuar të shenjës***

Evidenca për përdorim ligjor të elementëve të caktuar të inkorporuar në shenjë, siç janë simbolet shtetërore, mburojat, portretet, shenjat e nderit, titujt, emrat tregtarë, emra të personaliteteve të ndryshëm nga emrat e aplikuesve, ose përshkrime të tjera të ngjashme, që mund të kërkohen nga Entet e palëve nënshkruese do të përjashtohen nga çdo lloj legalizimi si dhe nga çdo lloj konfirmimi, ndryshe nga ai i entit të origjinës.

### **Neni 5 ter**

#### ***Kopje të regjistrimeve në Regjistrin Ndërkombëtar; Kërkime për prioritet; Ekstrakte nga Regjistri ndërkombëtar***

(1) Byroja ndërkombëtare do t'i lëshojë çdo personi që dorëzon kërkesë, pas pagesës së taksës së paraparë me Rregullore, kopje nga regjistrimi në Regjistrin ndërkombëtar që kanë të bëjnë me shenjën specifike.

(2) Byroja ndërkombëtare mund, gjithashtu, pas pagesës, të kryejë kërkim për prioritet midis shenjave që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar.

(3) Ekstraktet e regjistrimit ndërkombëtar të kërkuara me qëllim prodhimin e tyre në një nga palët nënshkruese do të përjashtohen nga çfarëdo qoftë legalizimi.

### **Neni 6**

#### ***Periudha e vlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar; Varësia dhe pavarësia e regjistrimit ndërkombëtar***

(1) Regjistrimi i shenjës në Byronë ndërkombëtare është i vlefshëm dhjetë vite, me mundësi rinovimi sipas kushteve të parapara në nenin 7.

(2) Pas skadimit të periudhës prej pesë viteve nga data e regjistrimit ndërkombëtar, ai regjistrim do të bëhet i pavarur nga aplikimi ose regjistrimi bazik që rezulton nga ai, ose nga regjistrimi bazik, varësisht nga rasti, dhe do të bëhet lëndë e dispozitave vijuese.

(3) Në mbrojtjen që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar, pa marrë parasysh se ka qenë apo jo lëndë e bartjes, nuk do të mund të thirret, para skadimit të periudhës prej pesë viteve nga data e regjistrimit ndërkombëtar, aplikimit ose regjistrimit bazik që rezulton nga ai, ose regjistrimit bazik, varësisht nga rasti, nëse është tërhequr, vjetërsuar, anuluar ose ka qenë lëndë e vendimit përfundimtar për refuzim, anulim, shfuqizim ose ndërprerje, në lidhje me të gjithë ose disa produkte dhe shërbime të cekura në regjistrimin ndërkombëtar. Kjo zbatohet nëse

(i) ankesa kundër vendimit refuzon vlefshmërinë e aplikacionit bazë,

(ii) veprimi që kërkon tërheqje ose revokim, anulim ose ndërprerje të regjistrimit që është rezultat i aplikimit bazë ose i regjistrimit bazë, ose

(iii) ankesa kundër aplikimit bazë rezulton, pas skadimit të periudhës prej pesë viteve, me vendim përfundimtar për refuzim, anulim, mosnjohje ose ndërprerje, ose kërkon refuzimin e aplikacionit bazik, ose regjistrimit që rezulton nga ai, ose të regjistrimit bazik, varësisht nga rasti, duke siguruar që ankesa e tillë, veprimi ose kundërshtimi ka filluar para skadimit të periudhës në fjalë. E njëjta publikohet nëse aplikacioni bazik është refuzuar, ose regjistrimi që rezulton nga aplikacioni bazik ose regjistrimi bazik është anuluar, pas skadimit të periudhës prej pesë viteve, duke siguruar, në kohën e refuzimit ose anulimit, aplikacioni ose regjistrimi në fjalë kanë qenë lëndë e veprimeve të cekura në (i), (ii) ose (iii), dhe se këto veprime kanë filluar para skadimit të periudhës në fjalë.

(4) Enti i origjinës, siç është paraparë me Rregulloren, do të njoftojë Byronë ndërkombëtare për faktet dhe vendimet relevante sipas paragrafit (3), dhe Byroja ndërkombëtare, siç është paraparë me Rregulloren, do t'i njoftojë palët e interesuara dhe kjo do ta realizojë përmes shpalljes. Enti i prejardhjes, aty ku është e zbatueshme, do të kërkojë nga Byroja ndërkombëtare ta anulojë zgjerimin, aty ku është e zbatueshme, të regjistrimit ndërkombëtar, ndërsa Byroja ndërkombëtare këtë do ta bëjë.

## **Neni 7**

### ***Vazhdimi i vlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar***

(1) Çdo regjistrim ndërkombëtar mund të vazhdohet për periudhë prej dhjetë viteve nga data e skadimit të periudhës paraprake, përmes pagesës së taksës bazë, lëndë e nenit 8 (7), taksës plotësuese dhe komplementare të paraparë me nenin 8 (2).



(2) Vazhdimi nuk mund të sjellë asnjë ndryshim në regjistrimin ndërkombëtar nga forma e tij e fundit.

(3) Gjashtë muaj para skadimit të afatit për mbrojtje, Byroja ndërkombëtare, përmes dërgesës së shkresës jozyrtare, do të rikujtojë bartësin e regjistrimit ndërkombëtar dhe përfaqësuesin e tij, nëse ka një të tillë, për datën e saktë të skadimit.

(4) Do të lejohet periudhë kalimtare prej gjashtë muajsh për rinovimin e regjistrimit, në përputhje me pagesat e përcaktuara në rregullore.

## **Neni 8**

### ***Taksa për aplikacion dhe regjistrim ndërkombëtar***

(1) Enti i origjinës, mund të përcaktojë, sipas vlerësimeve të veta, dhe të grumbullojë për llogari të vetë, taksën e cila mund të kërkohet nga aplikuesi i regjistrimit ndërkombëtar ose nga bartësi për regjistrimin ndërkombëtar në lidhje me dorëzimin e aplikacionit ndërkombëtar ose kërkesën për vazhdimin e regjistrimit ndërkombëtar.

(2) Regjistrimi i shenjës në Byronë ndërkombëtare do të jetë subjekt i pagesës paraprake të taksës ndërkombëtare e cila, në pajtim me dispozitat e paragrafit (7)(a), përfshin:

- (i) taksën bazike
- (ii) taksën shtesë për çdo klasë të klasifikimit ndërkombëtar, më shumë se tre, për të cilën kërkohet zbatimi i mallrave dhe shërbimeve për atë shenjë (markë tregtare)
- (iii) taksën komplementare për çdo kërkesë për zgjerimin e mbrojtjes sipas nenit 3 ter.

(3) Sidoqoftë, taksa shtesë, e specifikuar në paragrafin (2) (ii) mund, pa marrë parasysh datën e regjistrimit ndërkombëtar, të paguhet në periudhën e paraparë me Rregullore në qoftë se numri i klasave të produkteve dhe shërbimeve është përcaktuar ose është kontestuar nga Byroja ndërkombëtare. Nëse pas skadimit të periudhës në fjalë, taksa plotësuese nuk është paguar ose lista e mallrave dhe shërbimeve nuk është reduktuar sipas kërkesës për zgjerim të aplikuesit, aplikacioni ndërkombëtar do ta konsiderojë si të anuluar.

(4) Produkti (Shuma) vjetor nga të ardhurat e ndryshme të regjistrimit ndërkombëtar, përveç të ardhurave që rezultojnë nga taksat e parashikuara me paragrafin (2) (ii) dhe (iii), do të ndahen në mënyrë të barabartë për Palët nënshkruese nga Byroja ndërkombëtare, pas zbritjes së shpenzimeve dhe të taksave të nevojshme për realizimin e këtij Protokolli.

(5) Shumat që rezultojnë nga taksat shtesë që rezultojnë nga paragrafi (2) (ii) do të ndahen, pas përfundimit të çdo viti, midis palëve të interesuara nënshkruese, në proporcion sipas numrit të shenjave që janë paraqitur (aplikuar) për secilën prej tyre gjatë

atij viti, ai numër shumëzohet, në rastet kur palët nënshkrues kryejnë ekzaminime (shqyrtime), me koeficientin i cili do të përcaktohet me Rregullore.

(6) Shuma që rezulton nga taksat komplementare të parapara me paragrafin (2) (iii) do të ndahet sipas të njëjtës rregullore të cekur në paragrafin (5).

(7)(a) Secila palë nënshkruese mund të deklarojë, në lidhje me çdo regjistrim ndërkombëtar në të cilën është përmendur sipas nenit 3 ter, dhe në lidhje me rinovimin e çdo regjistrimi të tillë ndërkombëtar, se ajo dëshiron ta pranojë, edhe përkaj pjesës së të ardhurave që rezultojnë nga taksa shtesë dhe komplementare, taksën (në tekstin e mëposhtëm “taksën individuale”) shuma e të cilit do të ceket në deklaratë, dhe do të mund të ndryshohet me deklarata të ardhshme, por që nuk mund të jetë më e lartë nga ekuivalenti i shumës që Enti i palës nënshkruese në fjalë do ta pranonte nga aplikuesi për regjistrim dhjetëvjeçar ose nga bartësi i regjistrimit për rinovim të atij regjistrimi, për shenjën në regjistrin e atij Enti, shuma në fjalë e zvogëluar për shpenzimet që rezultojnë nga procedura ndërkombëtare. Kur paguhet taksa e këtillë individuale

- (i) taksa shtesë e cekur në paragrafin (2) (ii) nuk do të paguhet në qoftë se pala nënshkruese që dhënë deklaratë sipas kësaj pike është cekur në neni n3 ter, dhe
- (ii) taksa komplementare e cekur në paragrafin (2) (iii) nuk do të paguhet për asnjë palë nënshkruese që ka dorëzuar deklaratë sipas kësaj pike.

(b) Çdo deklaratë sipas pikës (a) mund të bëhet me anë të instrumenteve të cekura në neni n14 (2), dhe data e hyrjes në fuqi e deklaratës do të jetë e njëjta sikur data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit në përputhje me deklaratën e organizatës ndërqeveritare të shteteve. Çdo deklaratë e tillë mund të dorëzohet edhe më vonë, në atë rast deklarata hyn në fuqi tre muaj pas pranimin nga ana e drejtorit gjeneral ose në datë të mëvonshme të cekur në deklaratë, në lidhje me çdo regjistrim ndërkombëtar data e të cilit është e njëjtë ose më e vonshme se data e hyrjes në fuqi të deklaratës.

## **Neni 9**

### ***Regjistrimi (evidentimi) i ndryshimeve në pronësinë e regjistrimit ndërkombëtar***

Me kërkesë të personit në emër të të cilit qëndron (udhëhiqet) regjistrimi ndërkombëtar ose me kërkesë të entit të interesuar të kryer *ex officio* ose me kërkesë të personit të interesuar, Byroja ndërkombëtare do ta evidentojë (regjistrojë) në Regjistrin ndërkombëtar çdo ndryshim në pronësinë e atij regjistrimi, në lidhje me të gjitha ose disa palë nënshkruese në territoret e të cilave vlen regjistrimi në fjalë në lidhje me të gjitha ose me disa produkte dhe shërbime të cekura në regjistrim, duke siguruar se bartësi i ri i cili, sipas nenit 2(1) është emëruar që ta dorëzojë regjistrimin ndërkombëtar.

## **Neni 9 bis**

### ***Regjistrimi (evidentimi) i të dhënave të caktuara që kanë të bëjnë me***

### ***regjistrimin ndërkombëtar***

Byroja ndërkombëtare do të regjistrojë (evidentojë) në Regjistrin ndërkombëtar

- (i) çdo ndryshim në emrin dhe adresën e bartësit të regjistrimit ndërkombëtar,
- (ii) emërim (autorizim) të përfaqësuesit të bartësit të regjistrimit ndërkombëtar dhe çdo fakt tjetër relevant që ka të bëjë me atë përfaqësues,
- (iii) çdo kufizim, në lidhje me të gjitha ose disa palë nënshkruese, për mallrat dhe shërbimet e cekura në regjistrimin ndërkombëtar,
- (iv) çdo anulim, ndërprerje ose anulim të regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me të gjitha ose disa nga palët nënshkruese,
- (v) çdo të dhënë tjetër relevante, sipas Rregullores, që ka të bëjë me të drejtat e shenjës që është lëndë e regjistrimit ndërkombëtar.

### **Neni 9 ter**

#### ***Taksa për regjistrime të caktuara***

Çdo regjistrim sipas nenit 9 dhe nenit 9 bis mund të jetë lëndë e pagesës së taksës.

### **Neni 9 quarter**

#### ***Enti i përbashkët për disa palë nënshkruese***

(1) Nëse disa palë (shtete) nënshkruese pajtohen të realizojnë unifikimin e legjislacionit të tyre vendor për shenjat (markat tregtare), ata mund të njoftojnë Drejtorin gjeneral:

- (i) se Enti i përbashkët do të zëvendësojë entit nacional për secilin prej tyre, dhe
- (ii) se tërësia e territoreve të tyre do të konsiderohet si një Shtet për qëllime të aplikimit për të gjitha ose një pjesë të dispozitave që kanë përparësi në këtë nen një të sikur në nenet 9 quinquies dhe 9 sexies.

(2) Njoftimi i tillë do të hyjë në fuqi në periudhë prej tre muajsh pas datës së njoftimit lidhur me atë, nga drejtori gjeneral deri tek Palët nënshkruese.

### **Neni 9 quinquies**

#### ***Transformimi i regjistrimit ndërkombëtar në aplikacion nacional ose regional***

Në rastet kur regjistrimi ndërkombëtar k pushuar me kërkesë të Entit të Entit të origjinës sipas nenit 6 (4), në lidhje me të gjitha ose disa mallra dhe shërbime të cekura në regjistrimin në fjalë, personi që ka qenë bartës i regjistrimit ndërkombëtar dorëzon

aplikacion për regjistrimin e të njëjtës markë (shenjë) në Entin e cilësdo qoftë palë nënshkruese në territorin e së cilës ka vlejtur regjistrimi ndërkombëtar, ai aplikim do të trajtohet sikur të jetë dorëzuar në datën e regjistrimit ndërkombëtar sipas nenit 3 (4) ose në datën e regjistrimit të zgjerimit territorial sipas nenit 3 ter (2) dhe, në qoftë se regjistrimi ndërkombëtarë ka gëzuar të drejtën e prioritetit, do të gëzojë të njëjtin prioritet, duke siguruar që

- (i) ai aplikacion është dorëzuar në periudhë prej tre muajve nga data kur regjistrimi ndërkombëtar është ndërprerë,
- (ii) mallrat dhe shërbimet e cekura në aplikacion janë të njëjtat mallra dhe shërbime të përmbajtura në regjistrimin ndërkombëtar në lidhje me palët nënshkruese për të cilat bëhet fjalë, dhe
- (iii) aplikimi i tillë i plotëson të gjitha kërkesat e ligjit të aplikueshëm, duke përfshirë edhe kërkesat që kanë të bëjnë me taksat.

## **Neni 9 sexies**

### ***Sigurimi i Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit)***

(1) Në rastet kur, lidhur me aplikacionin e dhënë ndërkombëtar ose regjistrimin e dhënë ndërkombëtar, enti i origjinës është ent i shtetit që është anëtare e këtij protokollit dhe i Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit), dispozitat nga ky protokoll nuk do të kenë vlefshmëri në territorin e ndonjë shteti tjetër që gjithashtu është anëtare e këtij protokollit dhe e Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit).

(2) Kuvendi, mundet, me shumicë prej tre të katërtat, të shfuqizojë paragrafin (1), ose të kufizojë ndikimin e paragrafit (1), pas skadimit të periudhës prej dhjetë viteve nga hyrja në fuqi e këtij protokollit, por, jo para skadimit të periudhës prej pesë viteve nga data në të cilën shumica e shteteve anëtare të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit) janë bërë anëtare edhe të këtij Protokollit. Në votim në Kuvend, vetëm ato shtete që janë anëtare të marrëveshjes në fjalë dhe të këtij protokollit do të kenë të drejtë të marrin pjesë.

## **Neni 10**

### ***Kuvendi***

- (1)
  - (a) Palët nënshkruese do të jenë anëtare të të njëjtit Kuvend si edhe shtetet anëtare të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit).
  - (b) Çdo palë nënshkruese do të përfaqësohet në atë Kuvend me një delegat, të cilit mund t'i ndihmojnë delegatë të tjerë, këshilltarë dhe ekspertë.
  - (c) Shpenzimet e çdo delegati do të jenë në barrë të palës nënshkruese që e ka emëruar, përveç shpenzimet rrugore dhe mëditjet për një delegat nga çdo palë nënshkruese, të cilat do të paguhen nga fondet e Unionit.

(2) Kuvendi, në shtesë të funksionet që i ka sipas Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit), gjithashtu do të:

- (i) kryej punë që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij protokoll;
- (ii) jep urdhra deri te Byroja ndërkombëtare që kanë të bëjnë me përgatitjen e konferencave për rishikim të këtij protokoll, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e atyre shteteve që nuk janë anëtarë të këtij protokoll;
- (iii) miratojë dhe modifikojë dispozitat e Rregullores që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij Protokoll;
- (iv) kryej edhe funksione të tjera siç është parashikuar me këtë protokoll.

(3) (a) Çdo palë nënshkruese do të ketë nga një votë në Kuvend. Për çështjet që kanë të bëjnë vetëm me shtetet që janë anëtare të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit), palët nënshkruese që nuk janë anëtare të asaj Marrëveshje nuk do të kenë të drejtë vote, për çështjet që kanë të bëjnë vetëm me palët nënshkruese, vetëm këto të fundit do të kenë të drejtën e votimit.

(b) Njëra gjysmë e anëtarëve të Kuvendit që kanë të drejtë vote për çështje të caktuar paraqet kuorumin për qëllime të votimit për atë çështje.

(c) Duke mos mohuar dispozitat nga pika (b), nëse, gjatë ndonjë sesioni, numri i anëtarëve të pranishëm në Kuvend e që kanë të drejtë vote për çështje të caktuara është më i vogël se gjysma por i barabartë ose më i madh se një e treta e anëtarëve të Kuvendit që kanë të drejtë vote për çështje të caktuara, Kuvendi mund të sjellë vendim, por, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me vetë procedurën e saj, të gjitha vendimet e tilla do të hyjnë në fuqi vetëm nëse janë plotësuar kushtet e vendosura këtu. Byroja ndërkombëtare do t'i dorëzojë vendimet në fjalë deri tek anëtarët e Kuvendit me të drejtë vote për çështjet në fjalë dhe që nuk kanë qenë të pranishëm dhe do t'i ftojë ata të votojnë në formë të shkruar ose të abstenojnë (përmbahen) në periudhë prej tre muajve nga data e komunikimit. Nëse, pas skadimit të kësaj periudhe, numri i atyre anëtarëve që kanë dhënë votën e tyre ose kanë abstenuar arrin numrin e anëtarëve që kanë munguar për të u plotësuar kuorumi në sesion, vendimet e tilla do të hyjnë në fuqi, duke paraparë se në të njëjtën kohë është arritur shumica e kërkuar.

(d) Në përputhje me dispozitat e neneve 5 (2) (e), 9 sexies (2), 12 dhe 13 (2), për vendimet e kuvendit kërkohet shumicë prej dy të tretave të votave.

(e) Abstenimi nuk llogaritet si votë.

(f) Delegati mund të përfaqësojë dhe të votojë vetëm në emër të një anëtari të Kuvendit.

(4) Në plotësimet në takimet në seancat e rregullta dhe të jashtëzakonshme siç është paraparë me Marrëveshjen e Madridit (Stokholmit), Kuvendi do të takohet në seancë (mbledhje) të jashtëzakonshme të thirrur nga drejtori gjeneral, me kërkesë të një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit që kanë të drejtë vote për çështjet që duhet të shtrohen në rend dite për atë seancë. Rendin ditor për seancë të tillë e përgatit drejtori gjeneral.

## Neni 11

### ***Byroja ndërkombëtare***

(1) Regjistrimi ndërkombëtar dhe veprimet e ngjashme, si edhe e gjithë puna administrative, sipas dhe lidhur me këtë Protokoll, do të kryhen nga ana e Byrosë ndërkombëtare.

(2) (a) Byroja ndërkombëtare, në pajtim me udhëzimet e Kuvendit, do të kryej përgatitjet e konferencave për rishikim të këtij Protokollit.

(b) Byroja ndërkombëtare mund të konsultohet me organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare në lidhje m përgatitjet për konferenca të tilla për rishikim.

(c) Drejtori gjeneral dhe personat e emëruar (caktuar) nga ai do të marrin pjesë, pa të dejtë vote, në diskutimet e atyre konferencave për rishikim.

(3) Byroja ndërkombëtare do të kryej të gjitha punët tjera të caktuara lidhur me këtë Protokoll.

### **Neni 12**

#### ***Financimi***

Derisa ka të bëjë me palët nënshkruese, financimi i Unionit do të kryhet sipas të njëjtave dispozita sikur ato të cekura në nenin 12 të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit), duke siguruar që gjithçka që është cekur në nenin 8 të marrëveshjes në fjalë do të konsiderohet se është pjesë e nenit 8 të këtij Protokollit. Më tej, për qëllimet e nenit 12 (6) (b) të Marrëveshjes në fjalë, organizatat nënshkruese, me vendim unanim, të kundërt me Kuvendin, do të konsiderohet se kontributi që duhet ta paguajnë i takon klasës 1 (një) sipas Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale.

### **Neni 13**

#### ***Plotësimet të neneve të caktuara të Protokollit***

(1) Propozimet për plotësimin e neneve 10,11,12 dhe këtë nen, mund të iniciojë çdo palë nënshkruese, ose drejtori gjeneral. Propozimet e tilla do të dërgohen nga drejtori gjeneral tek palët nënshkruese të paktën gjashtë muaj para shqyrtimit të tyre në Kuvend.

(2) Plotësimet e neneve të cekura në paragrafin (1) do të miratohen nga Kuvendi. Për miratim kërkohen tri të katërtat e votave, duke parashikuar që për çdo plotësim të nenit 10 dhe të këtij paragrafi të kërkohen katër të pestat e votave.

(3) Çdo plotësim i neneve të cekur në paragrafin (1) do të hyjë në fuqi një muaj pas njoftimit me shkrim për pranim, të pranuar nga ana e drejtorit gjeneral nga tri të

katërtat e atyre shteteve dhe organizatave ndërqeveritare të cilat, në kohën kur plotësimi është miratuar, kanë qenë anëtarë të Kuvendit dhe kanë pasur të drejtë të votojnë plotësimet. Çdo plotësim për nenet në fjalë i pranuar në këtë mënyrë do t'i obligojë të gjitha shtetet dhe organizatat ndërqeveritare që janë pale nënshkruese në kohën kur plotësimi hynë në fuqi, ose kur janë bërë pale nënshkruese në datën plotësuese.

## **Neni 14**

### ***Aderimi (anëtarësimi) në protokoll; Hyrja në fuqi***

(1) (a) Çdo shtet që është anëtar e Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale mund të bëhet anëtar e këtij Protokollit.

(b) Më tej, çdo organizatë ndërqeveritare mund gjithashtu të bëhet anëtar e këtij Protokollit nëse janë plotësuar kushtet në vijim:

- (i) të paktën një nga shtetet anëtare të asaj organizate të jetë anëtar i Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale;
- (ii) ajo organizatë të ketë ent regional për qëllimet e regjistrimit të shenjave që janë me vlefshmëri në territorin e asaj organizate, duke siguruar që ai Ent nuk është lëndë e njoftimit sipas nenit 9 quarter.

(2) Çdo shtet ose organizatë e cekur në paragrafin (1) mund të nënshkruaj Protokollin. Çdo shtet ose organizatë e tillë mundet, nëse ka nënshkruar Protokollin, të deponojë instrumentin për ratifikim, pranim ose miratim të këtij Protokollit ose, nëse nuk e ka nënshkruar këtë protokoll, të deponojë instrumentin për aderim në këtë Protokoll.

(3) Instrumentet e cekura në paragrafin (2) do të deponohen tek drejtori gjeneral.

(4) (a) Ky protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas deponimit të katër instrumenteve për ratifikim, pranim, miratim ose aderim, duke siguruar që të paktën një nga këto instrumente duhet të deponohet nga shteti anëtarë i Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit) dhe të paktën një nga këto instrumente duhet të deponohet nga shteti që është anëtar e Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit) ose të ndonjëres prej organizatave të cekura në paragrafin (1)(b).

(b) Në lidhje me çdo shtet tjetër ose organizatë të cekur në paragrafin (1), ky protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën ratifikimi, pranimi, miratimi ose anëtarësimi (aderimi) i tij është njoftuar nga drejtori gjeneral.

(5) Çdo shtet ose organizatë e cekur në paragrafin (1) mund, kur deponon instrumentet e tij për ratifikim, pranim, miratim ose aderim në Protokoll, të deklarojë se, mbrojtja e cila është rezultat i ndonjë regjistrimi ndërkombëtar të kryer sipas Protokollit para datës së hyrjes në fuqi të këtij protokollit, nuk mund të zgjerohet mbi të.

## **Neni 15**

## ***Refuzimi***

(1) Ky protokoll do të hyjë në fuqi pa kufizim kohor.

(2) Çdo palë nënshkruese mund të heqë dorë nga ky Protokoll përmes njoftimit drejtuar deri te Drejtori gjeneral.

(3) Tërheqja do të hyjë në fuqi një vit pas ditës kur drejtori gjeneral ka pranuar njoftimin.

(4) E drejta e tërheqjes e paraparë me këtë nen nuk do të zbatohet nga palët nënshkruese para skadimit të periudhës prej pesë viteve nga data kur ky protokoll të ketë hyrë në fuqi tek ato palë nënshkruese.

(5) (a) Kur shenja (marka tregtare) është lëndë e regjistrimit ndërkombëtar që ka pasur vlefshmëri në shtetin që është tërhequr ose në organizatën ndërqeveritare në datën kur tërheqja ka hyrë në fuqi, bartësi i regjistrimit të tillë mund të dorëzojë aplikacion për regjistrimin e shenjës së njëjtë tek Enti i shtetit ose organizatës ndërqeveritare që është tërhequr (nga protokoll), që do të trajtohet sikur të jetë dorëzuar në datën e regjistrimit ndërkombëtar sipas nenit 3 (4) ose në datën e regjistrimit (evidentimit) të zgjerimit territorial sipas nenit 3 ter (2) dhe, në qoftë se regjistrimi ndërkombëtar ka gëzuar të drejtat e prioritetit, gëzon të njëjtin prioritet, duke siguruar që

- (i) aplikacioni i tillë është dorëzuar në afat prej dy viteve nga data në të cilën tërheqja (anulimi) ka hyrë në fuqi,
- (ii) mallrat dhe shërbimet e cekura në aplikacion janë të njëjtë me mallrat dhe shërbimet e përmbajtura në regjistrimin ndërkombëtar për shtetin ose organizatën ndërqeveritare e cila është tërhequr, dhe
- (iii) aplikacioni i tillë i plotëson të gjitha kërkesat e ligjit të aplikueshëm, përfshirë edhe kërkesat që kanë të bëjnë me taksat.

(b) Dispozitat nga pika (a) gjithashtu do të zbatohen në lidhje me çdo shenjë (markë tregtare) që është lëndë e regjistrimit ndërkombëtar që ka vlefshmëri tek palët nënshkruese më shumë se shteti ose organizata ndërqeveritare që janë tërhequr në datën në të cilën ajo tërheqje ka hyrë në fuqi dhe bartës i së cilës, për shkak të tërheqjes, nuk është përcaktuar më që të dorëzojë aplikacion ndërkombëtar sipas nenit 2 (1).

## **Neni 16**

### ***Nënshkrimi; Gjuhët; Funkcionet e depozitimit***

(1)(a) Protokollin do të nënshkruhet në një kopje në gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle, dhe do të deponohet te Drejtori gjeneral kur do të mbyllet për nënshkrim në Madrid. Teksti në tre gjuhët do të jetë me vlefshmëri të njëjtë.

(b) Tekstet zyrtare ët këtij protokollin do të miratohen nga drejtori gjeneral, pas konsultimit me qeveritë dhe organizatat e interesuara, në gjuhën arabe, kineze, gjermane,



italiane, japoneze, portugeze dhe ruse, dhe në gjuhët tjera që Kuvendi mund t'i përcaktojë.

(2) Ky protokoll do të mbetet i hapur për nënshkrim në Madrid deri më 31 dhjetor të vitit 1989.

(3) Drejtori gjeneral do të dërgojë dy kopje, të vërtetuara nga Qeveria e Spanjës, të teksteve të nënshkuara të këtij Protokoll, deri tek shtetet dhe organizatat ndërqeveritare që mund të bëhen anëtarë të kësaj marrëveshjeje.

(4) Drejtori gjeneral do të regjistrojë këtë Protokoll në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara.

(5) Drejtori gjeneral do t'i njoftojë të gjitha shtetet dhe organizatat ndërqeveritare, se mund të bëhen ose që janë anëtarë të këtij Protokoll, për nënshkrimet, deponimin e instrumenteve për ratifikim, pranim, miratim ose aderim (anëtarësim), për hyrjen në fuqi të këtij protokoll dhe për çdo plotësim të tij, për çdo njoftim për tërheqje (anulim) dhe për çdo deklaratë të parashikuar me këtë Protokoll.